

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:LINJA E JASHTME E UJESJELLESIT BISHNICË-VELCAN

Per hartimin e projektit “Linja e jashteme e Ujesjlesit Bishinice – Velcan”, grupi I projektimit eshte bazuar ne projektin e Hartuar nga Ing. Hodroteknik Bajram Balliu, Ing. Edmond Mecaj dhe Ing. Top. Edison Mecaj, projekt ky I mbartur nga ish Komuna Velcan.

Mbi bazen e matjeve ne terren, profilave gjatësore e tërthorë të nxjerre, si dhe pas vzhgimit ne terren kemi hartuar projektin e rishikuar. Kryesisht u bene ndryshime ne seksionin e tubit kryesor te ujesjellsit nga Tub me diameter 160 mm u mendua te vendosej tub D 200 mm, per te rritur eficencen e furnizimit me uje te fshatrave. Ne hartimin e ketij relacioni teknik nga ana jone eshte bere verifikimi ne vend nga ku rezulton: -Rjeti i jashtem i ujesjellesit Bishnice-Velcan eshte ndertuar rreth viteve 1980 clhe ka kaluar nje periudhe 28-vjecare dhe ky rrjet eshte pothuajse plotesisht i amortizuar.

Nga ky rrjet i jashtem furnizohen me uje dhe fshatrat Velcan , Losnik,Bishnice te Njesise Administrative Velcan si dhe fshati Slabinje i Njesise Administrative Proptisht.

Kjo linje e jashtme shtrihet ne Njesine administrative Velcan dhe qe fillon me burimet qe ndodhen ne pjesen veriperendimore dhe te siperme te fshatit Bish nice, rreth 450-500m larg nga kjo qender e banuar.Me tej linja vazhdon shtrirje ne Qafen e Bishnices ku dhe kalon ne nje tunel i hapur per kalimin e rrjetit te tubacionit i realizuar qysh ne vitet 1980 dhe sot ka ne nevoje per pastrim komplet pasi eshte i mbushur.Pas daljes nga tuneli ne gjatesine 295m eshte nje pusete shperndsarese ku jane dy degezimet,njera per linjen e jashtme per fshatin Losnik te Njesise Administrative Velcan dhe per fshatin Slabinje te Njesise Administrative Proptisht e kjo linje eshte financuar ne vitin 2011.Siperfaqja ku shtrijet kjo linje e jashtme eshte rreth 5 ha.

-Nga amortizimi i tepert i ketij rrjeti te jashtem te furnizimit me uje per 3(tre) qendrat e banuara ka mungese te theksuar te furnizimit me uje pasi ka shume humbje te sasise qe percjell kjo linje dhe per shkak te demtimeve te shumta ne kete rrjet.

Per kete arsye nga ana jone si projektues duke patur parasysh gjendjen aktuale te ketij rrjeti te jashtem te furnizimit me uje morem persiper hartimin e projekt-preventivit ne te cilin gjate hartimit kemi menduar si meposhte:

1. Burimet nga ku furnizohet rrjeti i jashtëm i këtij ujesjellesi janë në fshatin Bishnice të Njesisë Administrative Velcan dhe deri në dalje të tunelit që është objekt i këtij rrjeti ka demtime si dhe duke patur parasysh që nepermjet këtij rrjeti do të furnizohet dhe fshati Laktesh në një kohë jo shumë të vonë dhe për këtë arsye nga ana jone u mendua që diametri tubacionit nga burimi - pusteja shpërndarëse të jetë tubacion çeliku, \varnothing 300 mm, tubo çeliku, \varnothing 200 mm, saracineska \varnothing 300; PN 16, saracineska \varnothing 200; PN 16, F.V. fllanxha çeliku çift Pn÷16, \varnothing 300, F.V. fllanxha çeliku çift Pn÷16, \varnothing 200

2. Nga verifikimet e kryera nga ana jone rezulton se prurjet e ujit që do të perballojë ky rrjet i jashtëm për furnizimin me ujë të qendrave të banuara të fshatit Bishnice dhe Velcan dhe të jenë me se të mjaftueshme për nevojat e banoreve të këtyre qendrave të banuara.

Thëksojmë se në rastin tone konkret kemi të bëjmë me një linjë të jashtëme ujesjellesi me vet rrjedhje nga burimi tek konsumatori cka do të thotë që kemi veprimtari për gjithë ditën (24 ore) të furnizimit me ujë të zonave të banuar.

Për këtë arsye humbjet e ujit mund të ndodhin nga ferkimi i ujit në gjatesi të tubacionit dhe në humbjen e rezistencave lokale (berrylla, saracineska etj.)

$P_{ra} \cdot h = q^2 \cdot L = S \cdot q = Z_a - Z_b$ ose

$h = i \cdot L = Z_a - Z_b$

ku:

A - rezistenca specifike

q - prurja e ujit

i - pjerresia hidraulike

L - gjatesia e tubacionit

Nisur sa me sipër duke njohur nevojat për furnizim me ujë të zone të banuar me të cilën furnizon ky rrjet ujesjellesi i jashtëm, gjatesinë e tubacionit si dhe pjerresinë hidraulike kemi përcaktuar dhe diametrin e tubacioneve që do të vendosen në këtë rrjet të linjës të jashtëme. Gjithmone kemi patur parasysh që shpejtesia e levizjes të ujit në tubacion të jetë brenda kufijve të lejuar.

Gjate zbatimit të punimeve në këtë objekt duhet të kihet parasysh specifikimet teknike të hartuara nga ana jone.

Mendojmë se zbatimi i këtij projekti do të shërbejë me se miri nevojave të këtyre qendrave të banuara për furnizimin normal me ujë të pishem për nevojat të cilet ata kanë për jetën e tyre të përditshme.

HARTUAN

ING. OLTI BEGOLLARI

ING. ILIR VAKO

ING. KOCO TAVANXHIU

ING. VIOLETA ÇEKANI